

REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRY OF JUSTICE  
FERIZAJ

C.nr.448/13

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi dhe procesmbajtësen Valmira Sejdiu, në çështjen juridike, sipas padisë së paditëses [REDACTED], të cilën me autorizim e përfaqëson [REDACTED], e kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED], baza e kontestit shlyerja e borxhit, në seancën publike të mbajtur me datë 19.11.2015, merr këtë:

AKT GJYKIM

APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadija e paditëses P [REDACTED], me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED], që paditëses në emër shfrytëzimit të telefonit fiks [REDACTED] për periudhën nga muaji janar deri në dhjetor të vitit 2012 t’ia paguaj shumë prej 84,26 Euro, (tetëdhjetë e katër euro e njëzet e ajhtë cent) me kamatë e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetarëve, të afatizuara për periudhë një vjeqare pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e përpilimit të këtij Aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure në shumë prej 22.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, nën kërcënimin e përmbamit me dhunë.

Arsyetimi

Paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar padi (propozim për ekzekutim) në këtë Gjykatë më datë 06.02.2013, kundër të paditurit [REDACTED] për shkak të mos pagesës së faturave për shfrytëzimin e telefonisë fikse. Paditësja me padi dhe seancën e datës 19.11.2015 ka deklaruar se ndërmjet palëve ndërgjyqjese ekziston marrëdhënja juridike për dhënjën në shfrytëzim të telefonisë fikse, numrin [REDACTED], të cilin numër i padituri e ka shfrytëzuar për periudhën nga janari deri në dhjetor të vitit 2012 dhe nuk e ka paguar vlerën e arritur prej 84,26 Euro. Meqenëse i padituri nuk e ka prmbushur detyrimin e tij, paditësja ka ushtruar fillimin propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit të besueshëm autentik me nr. [REDACTED] të datës 21.01.2013. Po ashtu në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës ta aprovojë në tërësi padinë dhe kërkesën e saj sit ë bazuar dhe ta detyron të paditurin për përmbushjen e shumë prej 84,26 Euro në emër të shfrytëzimit të telefonisë fikse.

Gjykata për rastin konkret ka caktuar seancën me datë 19.11.2015, në të cilën present ka qenë përfaqësuesja e paditëse, ndërsa ka mundur i padituri edhe pse është ftuar me rregull në bazë të fletë dërgesës për dorëzim personal të datës 23.10.2015 dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Përfaqësuesja e paditëses i ka propozuar gjykatës që sesanca të mbahet në mungesë të të paditurit, meqenëse i njëjti i ka pranuar ftesën me rregull dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, për këtë arsye Gjykata e ka mbajtur seancën.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqjese përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka nxjerrë dhe administruar një sër provash:

-Fatura e dt.25.02.2012; Fatura e dt.25.03.2012; fatura e datës 25.04.2012; fatura e datës 25.05.2012; fatura e datës 25.06.2012; fatura e datës 25.07.2012; fatura e datës 28.08.2012; fatura e datës 25.09.2012; fatura e datës 25.10.2012; fatura e datës 25.11.2015 dhe fatura e datës 25.12.2012, në bazë të të cilave vërtetohet fakti se i padituri i ka mbetur borxh paditëses shumë prej 84,26 Euro, për shfrytëzimin e energjisë elektrike.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se padia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Pas vlerësimit dhe administrimit të provave dhe pohimeve të pales paditëse në seancën e datës 19.11.2015, Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i padituri [REDAKTUAR] i ka mbetur borxh paditëses shumë prej 84,26 Euro, për shfrytëzimin e telefonisë fikse për periudhën kohore nga janari deri në dhjetor të vitit 2012 kjo vërtetohet në bazë të fakturës së datës 25.12.2012;

-Se i padituri ka përgjegjësi juridike për përmbushjen e këtij detyrimi.

Palët në marrëdhënje detyrimore kanë për detyr të sillen më korrektësi ndaj njeri tjetrit dhe mos ti shkakojnë dëm, ky është një parim shumë i rëndësishëm i marrëdhënjeve detyrimore i paraparë në nenin 12 të LMD-së të vitit 1978, "në themelimin e marrëdhënjeve të detyrimeve dhe në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit kanë për detyrë t'i përmbahen parimit të ndërgjegjmerisë dhe ndërshmerisë".

Nga faktet e treguara në padinë e paditëses si dhe nga provat dhe shkresat që gjenden në lëndë, rezulton si e themelt në tërësi kërkesëpafia, se gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë kundërshti në mes provave të propozuara dhe fakteve të parashtruara nga paditësja. Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.



Gjykata duke u bazuar në nenin 143 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, neneve 12; 17 dhe 18 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, ndërsa për shpenzimet e procedurës e ka detyruar të paditurën në bazë të nenin 452.1 të LPK-së për dy seancat e mbajtura, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ  
C.nr.448/13, me datë 19.11.2015

Gjyqtari,  
Ardian Avyazi



Këshilla Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

07. 11/ 16

REPublika e KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUNDISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOBËZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROSEVAC

07. 11. 2016




Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAGWOST OTPRÁVKA POTVRĐUJE

Punëtori i autorizuar  
Orlistani radnik


